



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
KËSHILLI ADMINISTRATIV

V E N D I M

Nr. 08, datë 18.4.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV”

Në mbështetje të nenit 39, pika 2, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5, pika 1, shkronja “ll”, dhe të nenit 10, pika 1, shkronja “n”, të Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor,

V E N D O S I:

1. Të miratojë rregulloren “Për funksionimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT ADMINISTRATIV

ILIR BEQAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
KËSHILLI ADMINISTRATIV

R R E G U L L O R E

Nr. 2, datë 18.04.2014

PËR

FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV

Në mbështetje të nenit 39, pika 2, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të nenit 5, pika 1, shkronja "ll", dhe të nenit 10, pika 1, shkronja "n", të Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

1. Qëllimi

Qëllimi i rregullore është përcaktimi i rregullave dhe procedurave që duhet të zbatohen nga Komiteti i Shqyrtimit Administrativ në shqyrtimin e ankesave të paraqitura me shkrim nga personat e siguruar që përfitojnë nga skema, dhe dhënësit e kujdesit shëndetësor të kontraktuar nga Fondi për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara.

Ankimi bëhet ndaj vendimeve të gjobës, të pezullimit të përfitimeve, si dhe sanksioneve të tjera të marra në zbatim të kontratave që ka Fondi me dhënësit e shërbimeve, të dhëna nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme ose të Drejtorive Rajonale të Fondit.

2. Përkufizimet

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Rregullore" do të kuptohet rregullorja "Për funksionimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ".
- b) "Komiteti" do të kuptohet Komiteti i Shqyrtimit Administrativ.
- c) "Fondi" është Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.
- ç) "Drejtoritë Rajonale të Fondit" do të kuptohen subjektet juridike në varësi të Fondit, që e ushtrojnë veprimtarinë e Fondit në nivelin e Qarkut.

d) “Degët” do të kuptohen njësitë në varësi të Drejtorisë Rajonale të Fondit. Ato ushtrojnë veprimtarinë e Fondit në nivelin e Rrethit.

dh) “Personat e siguruar që përfitojnë nga skema” do të kuptohen të gjithë pacientët që kërkojnë të marrin shërbim shëndetësor, e që janë të siguruar sipas ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

e) “Dhënësit e kujdesit shëndetësor” do të kuptohen Qendrat Shëndetësore, spitalet, farmacitë (agjencitë farmaceutike), depot farmaceutike (importuese dhe distributore) të kontraktuara nga Fondi.

ë) “Subjekt ankimues” do të kuptohen të gjithë personat e siguruar që përfitojnë nga skema dhe dhënësit e kujdesit shëndetësor të kontraktuara nga Fondi për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara, që kanë të drejtën e ankimit.

f) “Ankim” do të kuptohet ankimi kundër vendimit të gjobës, të pezullimit të përfitimit, të dëmit ekonomik, të kushtit penal dhe zgjidhjes së kontratës.

3. Parimet e veprimtarisë

Në veprimtarinë e tij, në kuadër të shqyrtimit të ankesave, Komiteti respekton parimet e:

- a) ligjshmërisë;
- b) barazisë dhe mosdiskriminimit;
- c) pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrje;
- ç) shqyrtimit brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme;
- d) transparencës.

4. Organizimi dhe veprimtaria

Komiteti i Shqyrtimit Administrativ, organizohet, funksionon dhe ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Fusha

Në fushën e mbulimit të kësaj rregulloreje bëjnë pjesë:

- a) të gjithë personat e siguruar që përfitojnë nga skema;
- b) dhënësit e kujdesit shëndetësor të kontraktuara nga Fondi për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara.

6. E drejta e ankimit

Të drejtën e ankimit e kanë të gjithë personat e siguruar që përfitojnë nga skema dhe dhënësit e kujdesit shëndetësor të kontraktuar nga Fondi për ofrimin e shërbimeve të përcaktuara, të cilët nuk janë dakort ndaj vendimit të gjobës, të pezullimit të përfitimit, të dëmit ekonomik, të kushtit penal dhe zgjidhjes së kontratës.

Ankimi i paraqitet Komitetit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nxjerrja e vendimit.

7. Forma dhe përmbajtja e ankimit

Ankimi bëhet me shkrim dhe duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementët e mëposhtëm:

- a) të dhënat identifikuese të ankimuesit;
- b) adresën e ankimuesit;
- c) referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi;
- ç) një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar, dhe kur është e mundur, edhe bazën ligjore për këtë ankim;
- d) pretendimin e ankimuesit për vendimin përfundimtar;
- dh) provat dhe dokumentacionin përkatës, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komiteti.

8. Regjistrimi i ankimit

Ankesat për Komitetin e Shqyrtimit Administrativ pasi protokollohen nga Fondi, regjistrohen në një regjistër të veçantë, dhe i kalojnë për kompetencë kryetarit të Komitetit. Kryetari ose 1 (një) anëtar i caktuar nga Komiteti, në mënyrë zyrtare kërkon dokumentat përkatëse.

Kur praktika është e plotë kalohet për shqyrtim në Komitet.

9. Përbërja e Komitetit

Komiteti i Shqyrtimit Administrativ është një organ kolegjal, i cili përbëhet nga 2 (dy) jurist, 1 (një) specialist mjek, 1 (një) specialist farmacist, dhe 1 (një) specialist ekonomist, me strukturën që vijon:

- a) Kryetar 1 (një);
- b) Anëtarë 4 (katër).

Anëtarët dhe kryetari i Komitetit të Shqyrtimit Administrativ, emërohen e shkarkohen nga drejtori i Përgjithshëm i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

10. Sekretari

Komiteti i Shqyrtimit Administrativ cakton 1 (një) nga anëtarët e tij si sekretar, i cili ndjek praktikat e veprimtarisë së Komitetit, që nga paraqitja e ankimit deri në marrjen e vendimit.

11. Mbledhja e Komitetit

Kryetari thërret mbledhjen e Komitetit në varësi të ankesave të paraqitura nga personat e siguruar që përfitojnë nga skema dhe dhënësit e kujdesit shëndetësor të kontraktuar nga Fondi, por jo më shumë se 2 (dy) herë në muaj.

Ankimi shqyrtohet në mënyrë të plotë e të gjithanshme, ku secili anëtar shpreh dhe argumenton mendimin e tij që pasqyrohet në procesverbalin e seancës. Procesverbali në përfundim nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët.

12. Kuorumi i mbledhjeve

Mbledhjet e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ zhvillohen me praninë e të gjithë anëtarëve. Në raste të veçanta, Komiteti mbledhet edhe pa praninë e të gjithë anëtarëve, por jo më pak se 3 (tre) anëtarë.

13. Afatet e shqyrtimit të ankimit

Komiteti i Shqyrtimit Administrativ merr vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit.

14. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit

Në rastin e paraqitjes së ankimit nga subjektet ankimuese, kryetari i Komitetit njofton Drejtorinë e Përgjithshme/Drejtorinë Rajonale të Fondit. Me dërgimin e njoftimit bëhet dhe pezullimi i ekzekutimit të vendimit deri në shqyrtimin e ankimit.

15. Vendimi i Komitetit

Në vendimet e marra nga Komiteti i Shqyrtimit Administrativ nuk lejohet abstenimi. Anëtari i Komitetit ka të drejtën e 1 (një) vote. Kur votat barazohen, do të ketë rivotim të dytë, në një ditë tjetër. Në rast se, dhe këtë herë nuk arrihet shumica, vota e kryetarit është vendimtare.

Pasi shqyrton çështjen, Komiteti merr vendim për:

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) ndryshimin e vendimit;
- c) shfuqizimin e vendimit.

Vendimi i Komitetit, i shoqëruar me një relacion dhe dokumentat mbështetëse i paraqitet drejtorit të Përgjithshëm të Fondit, i cili ia dërgon subjektit ankimues.

Komiteti i Shqyrtimit Administrativ administron gjithë praktikën e shqyrtimit të ankimit, një kopje e vendimit i dërgohet subjektit ankimues, 1 (një) kopje qëndron në protokoll dhe kopja tjetër administrohet në dosjen e Komitetit.

16. Ankimi kundër vendimit të Komitetit

Kundër vendimit të Komitetit të Shqyrtimit Administrativ, subjekti ankimues ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI I KËSHILLIT ADMINISTRATIV

ILIR BEQAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Këshilli Administrativ



Rr. "Sami Frashëri", nr. 8, Tiranë. Tel: +35542259835. E-mail: info@fsdksh.com.al. Web://www.fsdksksh.com.al

V E N D I M

Nr. 62, datë 01.08.2016

**“PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 2,
DATË 18.04.2014, “PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË
SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV””**

Në mbështetje të nenit 39, pika 2, të ligjit nr. 10 383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5, pika 1, shkronja “ll”, dhe të nenit 10, pika 1, shkronja “n”, të Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor,

V E N D O S I:

1. Në rregulloren nr. 2, datë 18.04.2014, “Për funksionimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ”, të miratuar me vendimin e Këshillit Administrativ nr. 68, datë 18.04.2014, “Për miratimin e rregullore për funksionimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Pika 6, paragrafi II, ndryshohet si vijon “Pala e interesuar ushtron të drejtën e ankimit pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë, nga marrja në dijeni e vendimit”.
- Pika 8, paragrafi I, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me përmbajtjen “Kur konstatohet se kërkesa ankimore nuk është e plotë, ajo i kthehet palës së interesuar me qëllim plotësimin/rregullimin e të metave brenda afatit 5 (pesë) ditor”.
- Pika 11, riformulohet si vijon “Kryetari thërret mbledhjen e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ në varësi të ankesave të paraqitura nga dhënësit e shërbimit të kujdesit shëndetësor të kontraktuar nga Fondi si dhe nga personat e siguruar që përfitojnë nga skema”.

“Ankimi shqyrtohet në mënyrë të plotë, ku secili anëtar shpreh dhe argumenton mendimin e tij”.

“Gjatë shqyrtimit të ankimit Komiteti i Shqyrtimit Administrativ ka të drejtë që kur e gjykon të arsyeshme të thërrasë në seancë dëgjimore edhe palët”.


- Pika 13, riformulohet si vijon “Komiteti i Shqyrtimit Administrativ merr vendimin brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor nga momenti i plotësimit të dosjes me dokumentacionin e nevojshëm”.

2. Ngarkohet Komiteti i Shqyrtimit Administrativ për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ILIR BEQAJ
KRYETAR I KËSHILLIT ADMINISTRATIV





FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR
Këshilli Administrativ

V E N D I M

Nr. 15, datë 31.05.2019

**“PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 2,
DATË 18.04.2014, “PËR FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË
SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV”**

Në mbështetje të nenit 39, pika 2, të ligjit nr.10 383, datë 24.02.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 5, pika 1, shkronja “ll”, dhe të nenit 10, pika 1, shkronja “n”, të Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Administrativ i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor,

V E N D O S I:

Në rregulloren Nr 2, datë 18.04.2014, “Për funksionimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ Nr. 68, datë 18.04.2014, “Për miratimin e rregullore për funksionimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 8 “Regjistrimi i ankimit”, ndryshohet si më poshtë:

“Ankimet drejtuar Komitetit të Shqyrtimit Administrativ (më poshtë referuar si “KSHA”), pasi protokollohen pranë Fondit, regjistrohen në një regjistër (manual/elektronik) të veçantë, nga sekretari i KSHA-së, dhe i përcillen për kompetencë kryetarit të Komitetit. Regjistri manual/elektronik përkatës duhet të përmbajë numrin e ankimit, datën e paraqitjes, objektin e ankimit, numrin e dokumenteve që i bashkëngjiten dhe emrin/mbiemrin e subjektit ankimues.”

2. Pika 9 “Përbërja e Komitetit”, ndryshohet si më poshtë:

“KSHA-ja është një organ kolegjal i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë nga të cilët: 1 (një) kryetar, dhe 4 (katër) anëtarë. Përbërja e anëtarëve është 1(një) jurist, 1(një) mjek, 1 (një) farmacist, 1(një) ekonomist. Kryetari dhe anëtarët e KSHA-së, së bashku me sekretarin emërohen dhe shkarkohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Fondit”.

3. Pika 10. “Sekretari” ndryshohet si më poshtë:

“Sekretari i KSHA-së është më profesion jurist dhe ndjek praktikën e veprimtarisë së këtij organi që nga paraqitja e ankimit, regjistrimi i tij, plotësimi i dosjes, mbledhjet e KSHA-së e deri në zbardhjen të vendimit përfundimtar të KSHA-së dhe njoftimin e palëve të interesuara.”

4. Pika 11 “Mbledhja e komitetit”, në titull e në përmbajtje, ndryshohet si vijon:

“11. Kryetari dhe mbledhja e Komitetit

Kryetari thërret mbledhjen e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ në menyre periodike. Për shqyrtimin e çdo ankimi të veçantë, kryetari, sipas kompetencës lëndore objekt ankimi, cakton një nga anëtarët si relator për përgatitjen dhe relatimin e çështjes në mbledhjen e Komitetit.

Kur konstatohet se ankimi nuk është në përputhje me pikën 7 të kësaj Rregulloreje ai i kthehet subjektit ankimues me qëllim plotësimin apo rregullimin e të metave brenda afatit 5 (pesë) ditor. Deri në atë datë ankimi mbetet pa veprime. Kur subjekti ankimues nuk plotëson të metat brenda afatit 5 ditor, ankimi konsiderohet se nuk është paraqitur dhe i kthehet subjektit ankimues bashkë me gjithë aktet shoqëruese

Nëse subjekti ankimues plotëson të metat brenda afatit 5 (pesë) ditor, ankimi shqyrtohet në mënyrë të plotë ku secili prej anëtarëve shpreh dhe argumenton mendimin e tij, i cili pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes që mbahet e regjistrohet në regjistrin e mbledhjeve nga ana e sekretarit të KSHA-së. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të KSHA-së.

KSHA-ja e mbështet gjykimin e rastit mbi dokumentacionin shkresor të paraqitur nga subjekti ankimues, mbi dokumentacionin shtesë që i kërkon palës ankuese ose strukturave të Fondit të përfshira në çështjen objekt gjykimi dhe sipas rastit, në shpjegimet e dhëna para Komitetit nga ana e palëve të përfshira në proces.

Kryetari i KSHA-së ka këto kompetenca:

- a) Përfaqëson KSHA-në.
- b) Përgatit, thërret e drejton seancat e KSHA-së.
- c) Bashkërendon punën midis anëtarëve të KSHA-së.
- ç) Nënshkruan vendimet e KSHA-së së bashku me anëtarët e tjerë.”

5. Pika 13 “Afatet e shqyrtimit të ankimit”, ndryshohet si më poshtë:

“KSHA-ja merr vendimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i plotësimit të dosjes me dokumentacionin e nevojshëm sipas pikës 11, por jo më vonë se afati i përfundimit të procedurës administrative.”

6. Pika 15 “Vendimi i Komitetit”, paragrafi i katërt, ndryshohet si më poshtë:

“Sekretari i KSHA-së administron të gjithë dokumentacionin e shqyrtimit të ankimit. Ai merr masa për t’u siguruar që vendimet të firmosen nga të gjithë anëtarët pjesmarrës të Komitetit dhe të depozitohen pranë Komitetit, protokollit të Fondit si dhe t’u dërgohen palëve të interesuara.”

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT ADMINISTRATIV

OGERTA MANASTIRLIU

